



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AVOKATURA E SHETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 3586 Prot.

Tiranë, më 31.12.2018

Lënda : Njoftim

**Drejtuar: Zyrave Vendore të Avokaturës së Shtetit
Avokatëve të Shtetit pranë zyrës qendrore**

Në kuadër të hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të miratuara me ligjin nr. 86/2018 «Për disa ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 «Për Avokaturën e Shtetit», punonjësit e Avokaturës së Shtetit që nuk gëzojnë statusin Avokat i Shtetit, do t'i nënshtrohen vlerësimit profesional sipas fazave dhe procedurave të miratuara me Rregulloren "Për procedurat e organizimit dhe fazat e zhvillimit të vlerësimit profesional të punonjësve të emëruar përkohësisht në pozicionin e avokatit të shtetit" me qëllim marrjen e titullit «Avokat Shtetit».

Sa më sipër, me anë të Urdhrit nr. 178, datë 31.12.2018, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është miratuar rregullorja "Për procedurat e organizimit dhe fazat e zhvillimit të vlerësimit profesional të punonjësve të emëruar përkohësisht në pozicionin e avokatit të shtetit", ndërsa me Urdhrin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr. 179, datë 31.12.2018, është miratuar programi për vlerësimin profesional të punonjësve të emëruar përkohësisht në pozicionin e avokatit të shtetit.

Rregullorja e sipërcituar, përcakton rregulla për procedurat e organizimit dhe fazat e zhvillimit të vlerësimit profesional të punonjësit të emëruar përkohësisht në pozicionin e avokatit të shtetit, i cili nuk gëzon titullin "Avokat Shteti", në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 86/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit".

Procedurave dhe fazave të vlerësimit profesional do t'i nënshtrohen të gjithë punonjësit e Avokaturës së Shtetit në të dy nivelet, të emëruar përkohësisht në pozicionin e avokatit të shtetit.

Për të gjithë të interesuarit, ju vëmë në dijeni e dy aktet e sipërcituara janë tashmë të publikuara edhe në faqen zyrtare të internetit të Avokaturës së Shtetit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHETIT

Artur METANI

